



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.61/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Faton Hyseni nga Zvicra, ka paraqitur apel kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i pa rregullt apeli i Faton Hysenit, me numër Anr.61/2019 e datës 20.09.2019, e parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Faton Hyseni nga Suedia, në të cilën pretendohet se nuk figuron në Listën përfundimtare për votues jashtë Kosovës edhe pse siq theksohet se aplikimin e ka bërë në afatet kohore me dokumentet me të cilat iu kan kërkuar. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur edhe aplikacionin për regjistrim të pranuar nga KQZ-ja , formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës si dhe lejën e identifikimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Faton Hyseni është i parregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas nenit 10 par.7 dhe nenit 5 par.7 të Rregullës Nr.02/2015.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.61/2019 më datën 20.09.2019.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*